



REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Prilimjena/Prodato Received/Delivery	23-09-2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMESHCK	5651/2022		114



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.669/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërjeje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Ilire Mehmeti Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.669/2022 të datës 27.07.2022 të parashtruar nga ankuesi nga Prishtina, me adresë banimi

“kërkesë nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 23.09.2022, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A nr.669/2022 të datës 27.07.2022 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, më datë 27.07.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 4339/2022/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokolli 2856/2022 të datës 28.06.2022 të Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për shkak të shkeljeve thelbësore të së drejtës së barabartë në punësim dhe vazhdim të karrierës në shërbim civil, diskriminimit në punë dhe karrierë, shkeljeve procedurale, mos aplikimit të dispozitave të Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, shkeljes së parimit të meritës dhe shkeljeve të afateve ligjore në vazhdim.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 29.07.2022 ka proceduar kërkesën e ankuesit për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (me tej MKRS). Ndërsa Këshilli, më datë 04.08.2022 ka pranuar shkresat lidhur me çështjen ankimore.



Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe duke marrë parasysh natyrën e çështjes me Vendimin Nr.89/2022 të datës 06.09.2022 të Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil është vazhduar afati për vendosje të ankesës me numër A.669/2022 të datës 27.07.2022 edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave për marrjen e vendimit meritor administroj këto prova: Ankesën me numër protokollit 4339/2022 të datës 27.07.202, Dokumentin e identifikimit të ankuesit; Vendimin me numër 707/2022 të datës 28.06.2022; Vendimin me numër 1242/2017 të datës 14.06.2017; Vendimin e datës 14.05.2009 lidhur me emërimin e ankuesit në pozitën Menaxher i Federatës së Sporteve; Ndryshim dhe Plotësimin e Akt emërimit me numër prorokollit 5682/2015 të datës 22.12.2015; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 4404/2022 të datës 29.07.2022; Përgjigjen në ankesë me numër të protokollit 4523/2022 të datës 04.08.2022; Përshkrimin e detyrave të punës 4606/2015 të datës 30.10.2015; Emalin me numër të protokollit 5137/2022 të datës 05.09.2022 të drejtuar Këshillit; Përshkrimin e detyrave të punës të datës 16.06.2004 për pozitën Menaxher i Sporti; Përshkrimin e detyrave të punës me numër të protokollit 4606/2015 të datës 30.10.2015 për pozitën Zyrtar për Sport për të Gjithë; Emalin e datës 05.07.2022 të drejtuar Këshillit; E-mailin e datës 05.09.2022 të Këshillit drejtuar E-mailin e datës 05.09.2022 te drejtuar Këshillit; Rregulloren (QRK) Nr.01/2014 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Ministrisë së Kulturës Rinis dhe Sportit; Vendimin me numër VK.nr.89/2022 të datës 06.09.2022 lidhur me vazhdimin e afatit për vendimmarrje; Provat shtesë me numër të protokollit 5168/2022 të datës 06.09.2022 të dërguara nga ankuesi si Akt emërimit me numër 1086/3/213 të datës 29.03.2013; Vendimin me numër KZKA Nr.07/2017 të datës 20.04.2017; Vendimin me NR.1242/2017 të datës 14.06.2017. Vendimin me Nr.133/2017 të datës 23.02.2017; Vendimin me Nr.829/2016 të datës 03.05.2016; Vendimin me numër A.02/249/2012 të datës 21.09.2012 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në vlerësimin e hollësishtëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi se ankesa e ankuesit është e palejueshme, *sepse*:

Nga vlerësimi i shkresave të lëndës gjegjësisht sipas Ndryshim dhe Plotësimit të Akt-it të Emërimit me numër protokollit 5682/2015 të datës 22.12.2015 dhe konfirmimit të datës 05.09.2022 të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit është konstatuar se ankuesi është i punësuar në pozitën e punës "Zyrtar për Sport për të Gjithë" në Departamentin e Sportit në MKRS-së. I njëjti me Vendimin me numër të protokollit 2743/2017 të datës 14.06.2017 të Sekretarit të Përgjithshëm të MKRS-së ishte emëruar Menaxher për këto Federata të Sportit: Federata e Hendbollit, Komiteti Paraolimpik, Federata e Sporteve të Personat me aftësi të kufizuara, Federata e Olimpiadës Speciale, Federata Tekewandos dhe Federata e Kick-Boksit. Ndërsa me Vendimin me numër të protokollit 2856/2022 të datës 29.06.2022, Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ka caktuar ankuesin si person përgjegjës për menaxhimin e Federatave si: Federatën e Motoçiklizmit të Kosovës, Federatën e Minigolfit të Kosovës, Federatën e Shigjetarisë të Kosovës dhe Federatën e Ping-Pongut të Kosovës.

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin me numër të protokollit 2856/2022 të datës 29.06.2022 të Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur

Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me pretendim ankimore se të njëjtit i është bërë ndryshimi i detyrave të punës, në mënyrë arbitrare, pa pëlqimin e tij dhe pa njoftimin paraprak, duke bërë shkelje thelbësore të së drejtës së barabartë në punësim dhe vazhdim të karrierës në shërbim civil, diskriminim në punësim dhe karriere, shkelje procedurale ligjore, mos aplikim i dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë shkelje e parimit të meritës, dhe shkelje e afateve ligjore.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit ka analizuar përshkrimin e detyrave të punës për pozitën e punës *Zyrtar për Sportin për të gjithë*, pozitë të cilën ankuesi e ushtron, dhe rrjedhimisht ka konstatuar së përveç detyrave tjera me renditje nga një (1) deri tetë (8), si një nga detyrat kryesore të ankuesit është edhe koordinimi dhe komunikimi i punës me autoritet e jashtëm, në rastin konkret me federatat e sportit. Ndërlidhur me këtë Kolegji ju referua edhe Rregullores (QRK) Nr.01/2014 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Ministrisë së Kulturës Rinis dhe Sportit përkatësisht nenit 15 sipas të cilit si detyra dhe përgjegjësi të Departamentit të Sportit janë përcaktuar: 1.1. *Harton dhe zbaton politikat programore, me anë të të cilave realizohen objektivat afatmesme dhe afatgjata për zhvillimin e sportit*; 1.2. *Harton dhe zbaton rregullativën ligjore që ka të bëjë me fushën e sportit*; 1.3. *Koordinon punët dhe aktivitetet të divizioneve, në funksion të mbështetjes dhe avancimit të federatave përkatëse sportive, infrastrukturës, si dhe sportit për të gjithë dhe atij shkollor*; 1.4. *Bën vlerësimin e projekteve për Subvencionimin e klubeve, federatave dhe reprezentacioneve sportive të cilat marrin pjesë në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare*; 1.5. *Ndihmon në ngritjen e kapaciteteve për trajnerë, gjyqtarë dhe administratorë të federatave të sportit. Ndihmon në krijimin e mekanizmave dhe programeve për aftësimin e punëtorëve sportivë, për hulumtime shkencore sportive*; 1.6. *Mbështet financiarisht reprezentacionet kombëtare, me prioritet sportet apo individët sportivë me rezultate kulmore në harmoni me legjislacionin*; 1.7. *Bën identifikimin dhe përkrah talentet e rinj sportiv*; 1.8. *Bën plotësimin e kritereve teknike-profesionale të infrastrukturës në bazë të kritereve të kërkuara nga asociacionet ndërkombëtare*; 1.9. *Përkrah riaktivizimin e klubeve sportive të mëparshme të sportit femëror me prioritet sportet olimpikë*; 1.10. *Inkurajon përfshirjen e klubeve multi -etnike në institucionet legale dhe të licencuara të sportit të Kosovës si dhe përkrah me pajisje sportive dhe në infrastrukturë me qëllim të zhvillimit të aftësive menaxhuese në aktivitetet sportive dhe institucionet e minoriteteve*; 1.11. *Bën promovimin e mëtutjeshëm të qendrës për mjekësi sportive dhe institucioneve tjera referente për mjekësi sportive, ngritjen e qendrës antropologjike shkencore në nivel kombëtar e cila bën hulumtimet kërkimore shkencore të të arriturave në sport*; 1.12. *Bën harmonizimin e kritereve për kontroll obligues mjekësor sipas standardeve ndërkombëtare të të gjithë sportistëve në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë*; 1.13. *Grumbullon dhe publikon të dhënat për të gjitha aktivitetet dhe institucionet dhe infrastrukturën sportive në bashkëpunim me Entin e Statistikave*. 2. *Udhëheqësi i Departamentit të Sportit raporton tek Sekretari i Përgjithshëm*. 3. *Në kuadër të këtij departamenti bëjnë pjesë divizionet*: 3.1. *Divizioni për Komitetin Olimpik të Kosovës, Komitetin Paraolimpik të Kosovës dhe Federatat Sportive*; 3.2. *Divizioni për Infrastrukturë Sportive*; 3.3. *Divizioni i Sportit për të Gjithë dhe Sportit Shkollor*. 4. *Numri i të punësuarve në Departamentin e Sportit është njëzetetë (23)*.

Po ashtu, Kolegji nga vlerësimi i shkresave të lëndës nuk arritur të vërtetoj faktin së Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka të aplikueshme ndonjë rregullativë të veçantë lidhur me caktimin e personave përgjegjës për menaxhimin e aktiviteteve të federatave të sportit, mirëpo sipas provave të parashtruara nga palët në procedurë rrjedhë së çështja e caktimit të personave përgjegjës për menaxhimin e aktiviteteve të Federatave të Sportit ka qenë në diskrecionin dhe përgjegjësinë e Sekretarit të Përgjithshëm, sepse që nga viti 2009 vendimet për emërimin e zyrtareve përgjegjës për menaxhimin e federatave të caktuar të sportit janë nxjerr nga Sekretari i

Përgjithshëm i MRKRS-së si Zyrtar Kryesor dhe përgjegjës për drejtimin e të gjithë veprimtarisë administrativo-profesionale të ministrisë.

Nisur nga rrethanat si me sipër, Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në nenin 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, konstaton se çdo nëpunës civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e punës. Kështu që në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe duke ju referuar nenit 124 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim...*, Kolegji i Këshillit vlerëson se me vendimin e kundërshtuara me ankesë nuk është cenuar ndonjë e drejtë apo interes juridik i ankuesit sepse bazuar në atë që u përshkrua me lart menaxhimi dhe komunikimi me federata e sportit është përgjegjësi e Departamentit të Sportit dhe rrjedhimisht një nga detyrat e zyrtarit për sport për të gjithë, andaj, bazuar në këtë konstatim si dhe në mbështetje të nenit 129 paragrafi 1 nen paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji konstaton se ankesa A.nr.669/2022 e datës 27.07.2022 e është e papranueshme.


Siç u tha me sipër, Kolegji i Këshillit pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nen paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit


Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.669/2022

Ilire Mehmeti-Shaqiri


Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj Demi


Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Zëvendës Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Kulturës Rinis dhe Sportit;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Kulturës Rinis dhe Sportit dhe
- Arkivit të KPMSHC-së.

